



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.02.2025

Nr: 192

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN  
NR. 41 ID, DATË 21.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTISË  
DEMOKRATIKE/PD**

Sot më datë 25.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

**KËRKUES:** Partia Demokratike

**SUBJEKT:** **Z. Blendi Gonxhja**  
Ministër për Ekonominë , Kulturën dhe Inovacionin

**OBJEKT:** Konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara nëpërmjet hapjes të Parkut Teknologjik dhe Shkencor “Durana Tech Park” dhe ofrimit të lehtësimit të taksave për bizneset, promovimi i investimeve në fushën e ekonomisë, teknologjisë dhe inovacionit

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator,

**KONSTATOJ:**

Partia Demokratike më datë 25.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 41 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashton sa vijon:

*“Partia Demokratike ka marrë dijeni se Ministri për Ekonominë, Kulturën dhe Inovacionin, z. Blendi Gonxhja ka publikuar krijimin e një Parku Teknologjik dhe Shkencor me emrin*

Data 25.02.2025

Nr: 192  
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 41 ID, datë 21.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

*“Durana Tech Park” dhe ka ftuar bizneset të aplikojnë për t’u bërë pjesë e këtij projekti. Ky park ashtu siç është publikuar nga vetë Ministri ofron lehtësira për bizneset si:*

- 0%Tvsh;
- 0%tatim mbi fitimin për kompanitë rezidente;
- 0%tatim mbi të ardhurat personale për 10 vite për punonjës;
- Kontribute shoqërore për punonjësit kufizohen në 95euro/muaj.

*Duke qenë se kjo nismë parashikon ofrimin e lehtësirave për bizneset pjesëmarrëse si dhe ka impakt me karakter ekonomik, vlerësojmë se investimi në këtë projekt dhe promovimi i tij nga Ministri për Ekonominë, Kulturën dhe Inovacionin, z. Blendi Gonxhja është veprim i kryer në shkelje të nenit 91/4 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator”.*

Nga sa më sipër çmuj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

### **V E N D O S:**

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
  - Z. Blendi Gonxhja, Ministër për Ekonominë, Kulturën dhe Inovacionin.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**